

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.12.2024 në ora 10:00 në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Dëshmorët e Baballoqit" në fshatin Baballoq, komuna Deçan, do të organizohet debat publik nga Kompania "FIDANI BETON" SH.P.K., në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën për Përpunimin, Thërrmimin dhe Seperimin e Rërës dhe Zhavorrit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPr68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "FIDANI BETON" SH.P.K. Deçan, për Depo për grumbullimin e frutave malore, përpunimi, prodhimi dhe ambalazhimi i lëngjeve dhe ujit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection and Waters/  
Departament za Zaštitu Sredine i Voda

<b>DATE/A:</b>	21.10.2024
<b>REFERENC-Ë:</b>	24/5890-2/616/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	“Fidani Beton” Shpk, Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Komisioni për VNM
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Njoftim për mbajtjen e Debatit Publik

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën e Juaj dhe pas shqyrtimit të saj ka përgatitur Njoftimin, që ia bashkëngjisim kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit , Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave/ Department of Environment Protection and Waters/  
Departament za Zaštitu Sredine i Voda

**NJOFTIM**

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka pranuar kërkesën dhe Raportin për VNM, si dhe dokumentacionin përcjellës të kompanisë “Fidani Beton” Shpk, Prishtinë me nr.prot.: 24/5890-2/616/DMMU për Pëlqim Mjedisor, për përpunimin, thërmimin dhe seperimin e rërës dhe zhavorit.

Prandaj, në kuadër të procedurave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe shqyrtimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për të cilin është bërë kërkesa për pëlqim Mjedisor, duhet të mbahet debati publik.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Njofton kompaninë “Fidani Beton” Shpk, Prishtinë se duhet të bëj organizimin për mbajtjen e debatit publik për Raportin e VNM-së, duke u bazuar në Neni 16. të Ligjit Nr. 08/L-181 për VNM.

Në bazë të nenit 9, paragrafët 4. dhe 5. të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.18/2015 për Informimin, pjesëmarrje të publikut dhe palëve të interesuara në procedurat e vlerësimit të ndikimit, njoftimin për planin dhe organizmin e mbajtjes së debatit publik duhet të dërgohet në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimin të njoftimit nga MMPHI, në të kundërtën nëse nuk respektohet afati ligjor i lartshënuar kërkesa e kompanisë “Fidani Beton” Shpk, Prishtinë do të ndërpritet procedura e shqyrtimit për pëlqim mjedisor.

Me respekt